



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	05.05.2021
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	Kosova Bike Group - Grupi i Çiklistëve të Kosovës
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës sektori
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Kosova Bike Group - Grupi i Çiklistëve të Kosovës me të cilën kërkohet që me datë 5 Maj 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike „Sheshi ”Ibrahim Rugova” nga ora 20:00 duke vazhduar sipas rutës së paraqitur në kërkesë.

Ky aktivitet do të mbahet me qëllim të sensibilizimit dhe vetëdijesimit e qytetarëve për sigurinë e çiklistëve në trafik dhe rritjen e dukshmërisë në komunikacion.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Ibrahim Rugova” me datën 5 Maj 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.